

SHTOJCA

SHTOJCË 1. INDEKSI I FORTËSISË FINANCIARE

Mbështetur në zhvillimet më të fundit të sektorit bankar është punuar për ndërtimin dhe llogaritjen e treguesit “Indeksi i Fortësisë Financiare”.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten treguesit financiarë, që ndihmojnë në llogaritjen e indeksit. Këta tregues vlerësojnë fortësinë financiare të sektorit bankar, zhvillimet dhe madhësinë e rreziqeve kryesore, ndaj të cilave ekspozohet ky i fundit. Në tabelë pasqyrohet edhe kahu i ndikimit të treguesve, si dhe peshat e tyre në formulën llogaritëse të secilit nënindeks. Shenja pozitive tregon efektin pozitiv në nën-indeks të rritjes së treguesit përkatës, ndërsa shenja negative flet për ndikimin negativ të kësaj rritjeje⁶² në nënindeks.

Tabela 23. Përbërësit e Indeksit të Fortësisë Financiare

	Treguesit e Fortësisë Financiare	Shenjat e Raporteve, lidhur me efektin që kanë mbi treguesit	Peshat
Cilësia e Aktiveve	Kreditë me probleme bruto/Kreditë totale	negative	0.33
	Kreditë me probleme neto/Kapitali aksioner	negative	0.33
	Aktive të qëndrueshme/Totali i Aktiveve*	negative	0.33
Likuiditeti	Aktive Likuide/Totali i Aktiveve	pozitive	0.40
	Aktive me maturim deri 3 muaj/Pasive me maturim deri 3 muaj	pozitive	0.60
Rreziku i kursit të këmbimit	Pozicionet në valutë në blerje dhe shitje/Kapitali rregullator	negative	0.50
	Pozicioni i hapur neto për të gjitha valutat/Kapitali rregullator	negative	0.50
Përfitueshmëria	Fitimi neto/Totali i Aktiveve	pozitive	0.50
	Fitimi neto/Kapitali aksioner	pozitive	0.50
Mjaftueshmëria e Kapitalit	Kapitali i lirë/Totali i Aktiveve**	pozitive	0.50
	Norma e Mjaftueshmërisë së Kapitalit	pozitive	0.50
Rreziku i normës së interesit	(Aktive - Pasive deri në 1 muaj, monedhë vendase)/Kapitali aksioner***	negative	0.50
	(Aktive - Pasive deri në 1 muaj, monedha të huaja)/Kapitali aksioner	negative	0.50

* Aktivët e qëndrueshme llogariten si shumë e mjeteve të qëndrueshme dhe e kredive me probleme neto.

** Kapitali i lirë llogaritet si diferencë midis kapitalit aksioner dhe aktiveve të qëndrueshme.

*** Diferenca midis aktiv-pasiveve deri në 1 muaj, si në monedhën vendase, ashtu dhe atë të huaj, tregon mospërputhjen e aktiv-pasiveve afatshkurtra të ndjeshme ndaj normës së interesit, e cila mund të shkaktojë humbje në rast luhatjesh të pafavorshme të kësaj norme.

⁶² Sipas kësaj metodologjie shenja negative nuk do të thotë vlerë negative. Shenja tregon vetëm drejtimin e efektit të secilit tregues (raport) mbi indeksin. Kështu, shenja pozitive do të thotë se indeksi rritet për shkak të një rritjeje të raportit, ndërsa shenja negative do të thotë se indeksi bie për shkak të kësaj rritjeje.

Për ndërtimin e nënindekseve, standardizohen seritë kohore të treguesve (raporteve), që shfrytëzohen për krijimin e tyre⁶³. Procesi i standardizimit realizohet nëpërmjet matjes së distancës së vlerës reale të treguesit (raportit) në një moment kohor nga mesatarja e vlerave përgjatë periudhës, në terma të devijimit standard.⁶⁴

Nëpërmjet kësaj llogaritjeje përftohet seria e re Z sipas formulës:

$$Z = \frac{X - \mu}{\sigma} \quad (1)$$

Ku: X -et përfaqësojnë vlerën e raportit në secilin moment kohor të analizuar, μ -ja përfaqëson mesataren e vlerave të raportit përgjatë periudhës së zgjedhur në analizë, dhe σ -ma përfaqëson devijimin standard. Në ndërtimin e nënindekseve të përshkruar më sipër, vlerat e standardizuara të raporteve sipas formulës (1), shumëzohen me peshat, që u janë caktuar raporteve në tabelën e mësipërme dhe përfundimisht mbledhen. Njëkohësisht është kryer dhe një rregullim, me qëllim kthimin në pozitive të të gjitha vlerave të standardizuara të serisë Z . Sipas metodologjisë, përzgjidhet një periudhë bazë, së cilës i jepet vlera 100⁶⁵ dhe indekset llogariten duke përdorur përpjesëtime direkte, kur rritja e raporteve që përbëjnë nënindekset është e favorshme, në rast të kundërt përdoren përpjesëtime indirekte⁶⁶. Në përfundim, Indeksi i Fortësisë Financiare (IFF) llogaritet si mesatare aritmetike e nënindekseve të ndërtuara.

Vlerësimi i nënindekseve, që formojnë Indeksin e Fortësisë Financiare (IFF), për sistemin në fund të gjashtëmuorit të parë 2011, jepet si më poshtë:

Nënindeksi i cilësisë së aktiveve⁶⁷: Ecuria në rënie e tij sinjalizon ndikim negativ mbi gjendjen e sektorit bankar dhe anashjelltas. Nën-indeksi i cilësisë së aktiveve ka vijuar të shfaqë tendencë rënëse sipas vlerave historike të tij. Në fund të gjashtëmuorit të parë të vitit 2011, vlera e nën-indeksit ra në 65.3 nga 71.2 që llogaritej në fund të vitit 2010 dhe 74 në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Vlerat e nën-indeksit të cilësisë së aktiveve luhaten ndjeshëm dhe nga mesatarja e periudhës e llogaritur në nivelin 85.9. Raportet bazë, që përbëjnë këtë nën-indeks, janë rritur në Qershor 2011 krahasuar me periudhën bazë. Rritja e vazhdueshme e këtyre treguesve flet për cilësinë në rënie të aktiveve të sistemit bankar.

⁶³ Të nën-indekseve.

⁶⁴ Në këtë mënyrë, bëhet diferenca midis vlerës së raportit në secilën periudhë me mesataren e vlerave për të gjithë periudhën e marrë në analizë (në rastin tonë Dhjetor 2005 – Dhjetor 2010) dhe kjo diferencë pjesëtohet me devijimin standard të periudhës së përzgjedhur.

⁶⁵ Në rastin tonë bëhet fjalë për periudhën dhjetor 2005.

⁶⁶ Rasti tipik i përdorimit të përpjesëtimeve indirekte është në lidhje me Nën-indeksin e Cilësisë së Aktiveve, ku rritja e raporteve që përbëjnë këtë nën-indeks (si psh hua me probleme ndaj kredive totale ose hua me probleme neto ndaj kapitalit aksioner) në fakt shkakton rënie të nën-indeksit të cilësisë së aktiveve, duke qenë se rritja e tyre është e pafavorshme për sistemin bankar. Realisht shenjat ose drejtimi i efekteve dhënë në tabelën e mësipërme shërbejnë për të vendosur nëse duhet të përdoren përpjesëtimet direkte ose indirekte.

⁶⁷ Për llogaritjen e këtij nën-indeksi është përdorur përpjesëtimi indirekt.

Nënindeksi i rrezikut të likuiditetit: Ecuria në rënie e tij sinjalizon ndikim negativ mbi gjendjen e sektorit bankar dhe anasjelltas. Në fund të gjashtëmuajorit të parë të vitit 2011, evidentojmë rënie të nën-indeksit të likuiditetit duke zbritur në nivelin 66.7 nga 79.5 të një gjashtëmuajori më parë dhe 76 në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Vlera e nën-indeksit të likuiditetit shfaqet më poshtë mesatares së periudhës. Kontributin kryesor në rënien e nën-indeksit e dha një prej raporteve përbërës të tij, konkretisht “aktive me maturitet deri në 3-muaj ndaj pasiveve me maturitet deri në 3-muaj”, raport i cili ra me rreth 10 pikë përqindje krahasuar me fundin e vitit 2010.

Nënindeksi i rrezikut të kursit të këmbimit⁶⁸: Ecuria në rritje e tij sinjalizon ndikim pozitiv në gjendjen e sektorit bankar dhe anasjelltas. Nën-indeksi i rrezikut të kursit të këmbimit në fund të gjashtëmuajorit të parë të vitit 2011, shënoi rritje në nivelin 115.5 nga 110.7 në fund të vitit 2010 dhe 111.1 në të njëjtë periudhë të një viti më parë. Përmirësimi i treguesit të rrezikut ndaj kursit të këmbimit u shkaktua kryesisht nga rënia e raportit “pozicione të hapura valutore (e përgjithshme) ndaj kapitalit rregullator”⁶⁹. Rritja e nën-indeksit sinjalizon kufizim të madhësisë së ekspozimit të sistemit bankar ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit.

Nënindeksi i përfitueshmërisë: Ecuria në rënie e tij sinjalizon ndikim negativ mbi gjendjen e sektorit bankar dhe anasjelltas. Vlera e nën-indeksit në fund të gjashtëmuajorit të parë të vitit 2011, zbriti në 73.6 nga 84.2 në fund të vitit 2010 dhe 86.2 në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rënia e vlerës së nën-indeksit ka ardhur kryesisht si rezultat i rënies së raportit të fitimit neto ndaj totalit të aktiveve⁷⁰. Ecuria në rënie e treguesve që përbëjnë nën-indeksin sinjalizon një ndikim negativ në gjendjen e sektorit bankar.

Nënindeksi i mjaftueshmërisë së kapitalit: Ecuria në rënie e tij sinjalizon ndikim negativ në gjendjen e sektorit bankar dhe anasjelltas. Ky nën-indeks përbëhet në pesha të barabarta nga raporti i “kapitalit të lirë/totalin e aktiveve” dhe norma e mjaftueshmërisë së kapitalit. Në Qershor 2011, vlera e nën-indeksit të mjaftueshmërisë së kapitalit ra ndjeshëm në nivelin 52.3 nga 76.6 në fund të vitit 2010 dhe 87.4 e njëjta periudhë një vit më parë. Vlera e nën-indeksit rezulton shumë poshtë dhe mesatares historike, e cila llogaritet 87.8. Kontributin në rënien e nën-indeksit të mjaftueshmërisë së kapitalit e dha kryesisht raporti “kapitali i lirë”⁷¹ ndaj totalit të aktiveve”, i cili në Qershor 2011 llogaritej 3.2 për qind, nga 4.7 për qind në fund të vitit 2010.

⁶⁸ Janë përdorur përpjestime indirekte në llogaritjen e këtij nën-indeksi, duke qenë se shenja (drejtimi i efektit) të përcaktuar në tabelë është negative.

⁶⁹ Në Qershor 2011, ky raport rezultoi 3.73% nga 5.03% në Dhjetor 2010.

⁷⁰ Raporti rezultoi 0.22% në Qershor 2011, nga rreth 0.77% në Qershor 2010.


⁷¹ Duke qenë se kapitali i lirë llogaritet si diferencë e kapitalit aksioner me aktivet fikse, ku këto të fundit llogariten si shumë e mjeteve të qëndrueshme dhe huave me probleme neto, është pikërisht rritja e konsiderueshme e huave me probleme neto, që ka ndikuar në rënien e kapitalit të lirë. Huatë me probleme neto në Qershor 2011 krahasuar me Dhjetor 2010, u rritën me rreth 32.6%.

Nënindeksi i rrezikut të normës së interesit⁷²: Ecuria në rritje e nën-indeksit sinjalizon ndikim pozitiv në gjendjen e sektorit bankar dhe anasjelltas. Ecuria e nën-indeksit të rrezikut të normës së interesit, paraqet rënie të ekspozimit të sistemit bankar ndaj rrezikut të luhatjes së normës në fund të gjashtëmuorit të parë të vitit 2011 krahasuar me fundin e vitit 2010, megjithatë ky risk paraqitet më i lartë referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë. Konkretisht, në Qershor 2011 vlera e nën-indeksit u ngjiti në 102.9 nga 95.3 në Dhjetor 2010 dhe 108.3 në Qershor 2010.

Indeksi i Fortësisë Financiare (IFF) llogaritet si mesatare aritmetike e të gjithë nën-indekseve të sipër analizuar. Efekti i kombinuar i tyre, ka rezultuar në rënie e indeksit të fortësisë financiare në fund të gjashtëmuorit të parë të vitit 2011, në nivelin 79.4 nga rreth 86.3 që u llogarit në fund të vitit 2010, njëkohësisht nën nivelin mesatar të periudhës prej 95.5.


Vlerësohet se në fund të gjashtëmuorit të parë të vitit 2011, vlera e indeksit të fortësisë financiare ka zbritur në nivelin 79.4 nga rreth 86.3 që u llogarit një gjashtëmuor më parë. Rënia prej rreth 7.9% e indeksit të fortësisë u shkaktua nga rënia e cilësisë së portofolit të kredisë, rënia e mjaftueshmërisë së kapitalit, rënia e likuiditetit dhe përfitueshmërisë së sistemit bankar. Ndërkohë, performanca pozitive i takon ekspozimit më të ulët ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit dhe atyre të normave të interesit.

Në vijim, paraqitet ecuria grafike e nën-indekseve dhe e indeksit të fortësisë financiare për sistemin bankar.



⁷² Rreziku i normës së interesit vlerësohet nëpërmjet mospërputhjes kohore të aktiveve dhe detyrimeve, e cila ekspozon sistemin bankar ndaj luhatjeve të normave të interesit. Është përdorur përpjesëtimi indirekt edhe për llogaritjen e këtij indeksi.

Grafik 86. Ecuria e IFF-së për sektorin bankar



Grafik 87. Ecuria e IFF-së për sistemin bankar




Tabela 24. Rezultatet për ecurinë e nën-indekseve dhe IFF-së.

Nën-indekset	Cilësisë së Aktiveve	Rreziku i Likuiditetit	Rreziku i Kursit të Këmbimit	Përfitueshmërisë	Mjaftueshmërisë së kapitalit	Rreziku i Normës së Interesit	Indeksi Fortësisë Financiare
Dhjetor 05	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00
Mars 06	97.96	100.87	103.92	106.37	100.00	100.19	101.55
Qershor 06	96.01	100.13	155.77	100.76	94.52	91.03	106.37
Shtator 06	97.96	97.28	107.84	100.19	94.52	96.94	99.12
Dhjetor 06	97.96	90.71	114.27	100.56	94.52	91.42	98.24
Mars 07	97.54	94.93	110.67	105.13	89.04	96.29	98.93
Qershor 07	97.54	89.23	144.05	106.69	89.04	94.14	103.45
Shtator 07	97.11	90.97	102.09	106.18	107.95	97.45	100.29
Dhjetor 07	96.70	86.51	150.96	104.57	89.04	94.20	103.66
Mars 08	94.79	89.85	105.51	97.40	89.04	97.03	95.61
Qershor 08	90.05	77.96	150.11	99.61	89.04	86.44	98.87
Shtator 08	90.42	83.79	122.09	98.09	89.04	89.95	95.56
Dhjetor 08	81.42	75.24	132.17	89.66	89.04	100.17	94.62
Mars 09	80.06	75.74	150.11	71.61	89.04	102.86	94.90
Qershor 09	79.03	69.55	126.52	72.17	89.04	112.22	91.42
Shtator 09	77.70	76.33	122.77	72.11	90.21	109.25	91.39
Dhjetor 09	76.45	75.94	135.83	77.68	88.86	113.66	94.74
Mars 10	74.41	87.13	120.21	84.34	86.20	105.16	92.91
Qershor 10	74.05	76.05	111.06	86.20	87.36	108.34	90.51
Shtator 10	71.62	89.97	130.81	81.18	76.94	109.35	93.31
Dhjetor 10	71.25	79.46	110.78	84.18	76.62	95.35	86.27
Mars 11	70.49	83.19	123.27	74.69	69.45	93.32	85.74
Qershor 11	65.30	66.72	115.54	73.65	52.35	102.93	79.41

Burimi Banka e Shqipërisë, Ilogaritje DSF

SHTOJCË 2. TREGUES TË SITUATËS FINANCIARE TË SEKTORIT BANKAR

SEKTORI BANKAR

Tabelë 25. Sektori bankar

(%)	Dhjetor 08	Dhjetor'09	Qershor 10	Dhjetor 10	Qershor 11
TREGUESIT ME BAZË KAPITALIN					
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të peshuara me risk	17.2	16.2	16.2	15.4	14.6
Kapitali bazë ndaj aktiveve të peshuara me risk	16.3	15.3	15.4	14.5	13.5
Kapitali bazë ndaj totalit të aktiveve	7.8	8.7	8.9	8.6	8.0
Kapitali rregullator ndaj totalit të aktiveve	8.3	9.2	9.3	9.1	8.7
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve	8.6	9.6	9.6	9.4	8.6
HUATË ME PROBLEME NETO NDAJ KAPITALIT					
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit bazë	23.0	29.9	32.8	38.1	51.3
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit rregullator	21.7	28.2	31.2	35.9	47.4
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit aksioner	21.1	27.1	30.3	34.8	47.6
HUATË ME PROBLEME BRUTO NDAJ TOTALIT TË HUAVE	6.64	10.48	12.21	13.96	17.00
KTHIMI NGA KAPITALI, ROE (bazë vjetore)	11.4	4.6	8.3	7.6	2.4
KTHIMI NGA AKTIVET, ROA (bazë vjetore)	0.9	0.4	0.8	0.7	0.2
TREGUES TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE					
Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto	106.5	119.6	116.2	118.9	146.6
Shpenzime jointeresi ndaj të ardhurave bruto	81.4	231.4	213.1	227.5	289.7
LIKUIDITETI					
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve	42.8	27.6	27.9	25.9	25.5
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit)	64.9	32.6	32.8	30.6	30.2
Raporti "depozita/kredi"	162.6	154.3	158.2	166.4	163.7
POZICIONI I HAPUR NETO NË VALUTË NDAJ KAPITALIT					
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit bazë	4.5	4.1	7.6	5.3	4.0
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit rregullator	4.3	3.9	7.3	5.0	3.7
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit aksioner	4.0	4.3	8.1	5.4	4.1